

UDHËTIM NË KINË

Dita 1 : Tiranë – Shanghai

Takimi me guidën rreth orës 15:30 në aeroport. Nisja nga Tirana në orën 18:25. Udhëtojmë drejt Mynihut, mbërrimë në orën 20:20. Marrim fluturimin për në Shanghai në orën 22:20.

Dita 2 : Mbërritja dhe mikpritja në Shanghai

Mbërritja në aeroportin e Shanghait . Më pas vijojmë me takimin e partnerëve tanë dhe nisemi për në Shanghai me trenin Transrapid, i cili arrin shpejtësi deri në 430 km/h. Pas zbritjes nga treni, marrim autobusin dhe drejtohemi për në hotel.

Konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në Shanghai Harbour Plaza Metropolitan Hotel.

Vaktet e përfshira : Darka

Dita 3 : Shanghai

Zgjohehi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Dita nis me një vizitë në Kopshtet Yuyuan, një shembull i shkëlqyer i arkitekturës tradicionale të kopshteve kineze nga Dinastia Ming. Ecni mes gjelbërimit, pavilioneve të hijshme dhe liqeneve plot lotus, ndërsa ndjeni qetësinë e këtij vendi magjik. Pranë kopshtit ndodhet Pazari i Qytetit të Vjetër, ku ngjyrat dhe gjallëria janë gjithkund. Ky Pazar është vendi ideal për të shijuar artizanatet tradicionale dhe ushqimet e shijshme të rrugës (street food).

Vazhdojmë vizitën me Tempullin e Jade Buddha, një oaz qetësie në qytet. Ky tempull ruan dy statuja madhështore të Budës, të skalitura me gurë të çmuar jade të bardhë. Dita përfundon me një shëtitje përgjatë Bregut të Shanghait (The Bund), ku ndërtesat koloniale historike bëjnë kontrast me qiellgërvishtëset futuristike të qytetit. Në mbrëmje, eksplorojmë rrugën e famshme të Nanjingut, një parajsë për blerje dhe shije kulinarie.

Konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në Shanghai Harbour Plaza Metropolitan Hotel.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 4 : Shanghai - Suzhou

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Udhëtojmë drejt Suzhou (100km ~ 1.5 orë), qytet i njohur për kopshtet elegante dhe degëzimet mahnitëse të ujit. Fillojmë vizitën me Kopshtin e Mjeshtërve të Rrjetave (Master of the Nets), një pasuri e trashëgimisë botërore të UNESCO-s që ofron një përjetim harmonik mes ujit dhe arkitekturës tradicionale.

Më pas vizitojmë një punishte mëndafshi, ku do të mësojmë për mjeshtërinë e prodhimit të mëndafshit, një art që ka karakterizuar Suzhou për shekuj. Eksplorojmë Portën Panmen, një nga portat më të lashta të qytetit që simbolizon mbrojtjen e tij historike. Dita mbyllet me një shëtitje në rrugën piktoreske Pingjiang, të mbushur me çajto, kafene dhe dyqane artizanale.

Konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në Days Hotel Suzhou.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 5 : Suzhou – Tongli – Xi'an

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Pas mëngjesit, nisemi nga Suzhou drejt qytetit të bukur ujor, Tongli, i njohur për historinë e tij mbi 1,000-vjeçare dhe kanalet e tij të qeta. Eksplorojmë këtë qytet të lashtë duke lundruar nëpër rrugët e tij ujore, të rrethuara nga shtëpi tradicionale të bardha dhe ura të harkuara prej guri. Atmosfera e qetë sjell një shije të së kaluarës së lavdishme të Kinës.

Më pas, vizitojmë Kopshtin e Tërheqjes dhe Reflektimit, një pasuri botërore e UNESCO-s dhe një shembull i shkëlqyer i dizajnit tradicional të kopshteve kineze. Ky kopsht magjepsës është i mbushur me pavione të zbukuruar, pellgje reflektuese dhe gjelbërim të harlisur, që mishërojnë harmoninë dhe balancën. Pas drekës, transferohemi për në aeroport për fluturimin drejt Xi'an.

Pas mbërritjes, konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në Novotel Xi'an Xinxing.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 6 : Ushtria e Terrakotës dhe Tregjet e Xi'an-it

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit, nisemi për në provincën e Lingtong (45km ~ 1 orë). Aty vizitojmë Ushtrinë e Terrakotës, një zbulim arkeologjik që përmban mijëra ushtarë, kuaj dhe qerre prej balte të ndërtuara për të ruajtur varrin e Perandorit të Parë të Kinës, Qin Shi Huang. Çdo figurë është unike në detaje, duke përfaqësuar fuqinë dhe pasurinë e kësaj dinastie.

Pasdite do të vizitojmë një punishte tradicionale të gdhendjes së nefritit dhe do të mësojmë për mjeshtërinë e përpunimit të këtij guri të çmuar. Përfundojmë ditën me një shëtitje në tregun e vjetër të Xi'anit, të mbushur me suvenire dhe specialitete lokale.

Konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në Novotel Xi'an Xinxing.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 7 : Xi'an - Pekin : Zbulimi i Qytetit të Ndaluar

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit, nisemi drejt Pekinit me tren të shpejtësisë së lartë dhe vizitojmë Qytetin e Ndaluar, një kompleks perandorak që ka shërbyer si selia e perandorëve kinezë gjatë Dinastive Ming dhe Qing. Eksplorojmë oborret e tij të mëdha, sallat madhështore dhe arkitekturën e mrekullueshme që pasqyrojnë fuqinë dhe arritjet artistike të Kinës së lashtë.

Konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në Mercure Wanshang Hotel Beijing.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka

Dita 8 : Pekin – Muri i Madh Kinez dhe Pallati Veror

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Më pas, nisemi drejt Murit të Madh Kinez në Juyong Pass, një nga pjesët më të ruajtura dhe mbresëlënëse të kësaj ndërtese ikonike. Aty do të shëtisim përgjatë rrugëve të tij të lashta dhe do të shijojmë pamjet panoramike të maleve të ashpra dhe luginave të gjelbra. Gjatë rrugës, vizitojmë dhe një punishte të perlave të freskëta, ku do të mësoni për kultivimin dhe mjeshtërinë e tyre, një pjesë e rëndësishme e kulturës kineze.

Pasdite, do të vizitohet Pallatin Veror, një vendpushim mbretëror i famshëm për kopshtet e tij elegante, pavionet e qeta dhe liqenin e madh Kunming. Ky vend, pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s, ofron një arratisje të qetë nga qyteti. Në mbrëmje, e mbyllim udhëtimin tonë me një darkë madhështore lamtumire duke shijuar rosën e Pekinit, një specialitet kulinar që përfaqëson kryeqytetin.

Konsumojmë darkën në grup në një restorant. Fjetja në Mercure Wanshang Hotel Beijing.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 9 : Pekin - Tiranë

Bëjmë check-out herët në mëngjes dhe nisemi për në aeroport për tu kthyer në Tiranë.

DETAJE RRETH HOTELEVE :

Harbour Plaza Metropolitan Hotel / Shanghai :

Adresa : No 55 Lane, 689 Liqan Rd, Putuo, Shanghai, China, 200333

Nr. Tel : [+86 21 6019 3888](tel:+862160193888)

Days Hotel / Suzhou :

Adresa : No.9 Yujing Road, Fengting Avenue, Suzhou, China

Nr. Tel : [+86 512 6299 5888](tel:+8651262995888)

New Friendship Hotel / Luoyang :

Adresa : No. 6, Xiyuan Road, Jianxi Qu, Luoyang, China

Nr. Tel : [+86 379 493 1445](tel:+863794931445)

Novotel Xi'an Xinxing / Xi'an :

Adresa : No.9 Huzhu Road, Beilin District, Xi'an, Shaanxi, China

Nr. Tel : [+86 29 8626 8888](tel:+862986268888)

Mercure Wanshang Hotel / Beijing :

Adresa : No.1 Yinhe Street, Shijingshan District, Beijing, China

Nr. Tel : [+86 10 6868 1199](tel:+861068681199)

Në çdo rast pakujdesie apo largimi nga grupi, pa mundur të ribashkoheni, gjithmonë mund të merrni një taxi dhe t'i tregoni vendndodhjen e hotelit në bazë të qytetit ku ndodheni

Elite Travel Agency

Elbasan: Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania

Tirana: Rruga e Atjonit, Tiranë (pranë shkollës Asim Vokshi)

www.elitetravel.al

DETAJE RRETH GUIDËS :

Guida Shqiptare : z.

Nr. Tel :

Guida Kineze :

Nr. Tel :

DETAJE RRETH FLUTURIMIT :

Fluturimi Shqiperi – Kinë 18 Maj 2025

Tirane (TIA) – Viene (VIE) : 06:00 – 07:30

Viene (VIE) – Shanghai (PVG) : 13:15 – 06:00 (19 Maj)

Fluturimi Kinë – Shqiperi 26 Maj 2025

Pekin (PEK) - Mynih (MUC) : 13:20 – 19:10

Mynih (MUC) – Tirane (TIA) : 21:45 – 23:30

Fluturimi Shqiperi – Kinë 23 Shtator 2025

Tirane (TIA) – Mynih (MUC) : 18:25 – 20:20

Mynih (MUC) – Shanghai (PVG) : 22:20 – 15:50 (24 Shtator)

Fluturimi Kinë – Shqiperi 01 Tetor 2025

Pekin (PEK) - Mynih (MUC) : 13:20 – 19:10

Mynih (MUC) – Tirane (TIA) : 21:45 – 23:30

DETAJE RRETH INTERNETIT / PARAVE :

Mund të blini kartë SIM në aeroport në Delhi ose të bëni roaming me kartën tuaj aktive në Shqipëri. Një mënyrë tjetër është të blini një E – Sim në internet dhe ta instaloni në bazë të pajisjes tuaj celulare.

Përsa i përket parave, lekët mund ti shkëmbeni në monedhën vendase, rupi indiane (INR) në aeroport. Monedhat kryesore të forta si USD, EURO, GBP mund të shkëmbehen lehtësisht. Ka bankomate ATM kudo dhe pranohen kartat ndërkombëtare. Guida shoqëruese do të ndihmojë nëse është e nevojshme.

Detajet e Turit

Ju lutem shikoni më poshtë të gjitha detajet e Turit

Përfshihen në çmim :

- Fluturimi Vajtje /Ardhje
- 5 netë akomodim ne hotele me 4 * në qëndër, 2 netë akomodim ne tren
- Mëngjesi, dreka & darka për pjesën më të madhe të ditëve
- Transferrat me autobus komod sipas programit
- Bileta e trenit Shangai – Xian me fjetje ne kompartimente 2-she
- Bileta e trenit Xian – Pekin me fjetje ne kompartimente 2-she
- Shërbimi i guidës lokale në anglisht
- Shoqërues nga Agjensia gjatë gjithë udhëtimit
- Biletat e hyrjeve në monumentet e përmendura në program

Nuk përfshihen në çmim :

- Vaktet të cilat nuk përmenden në program
- Shpenzime personale
- Cdo aktivitet qe nuk permendet ne rubriken “përfshihet”
- Bakshishe per shoferin dhe guiden

Politikat e Shërbimit

Elite Travel Agency

Elbasan: Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania

Tirana: Rruga e Atjonit, Tiranë (pranë shkollës Asim Vokshi)

www.elitetravel.al



Rezervimi me Elite Travel Agency është i sigurt dhe i thjeshtë

PA KOSTO TË FSHEHURA

Shikoni çdo çmim të mundshëm pa tarifa rezervimi ose kosto të tjera të fshehura.

SIGURI NË TRANSAKSIONET TUAJA

Ne ndjekim standardet më të larta të protokolleve të sigurisë për t'i ofruar mysafirëve tanë siguri "online".

POLITIKAT E PRIVATËSISË

Ne interesohemi për privatësinë e të dhënave tuaja personale dhe marrim të gjitha masat për t'u siguruar që jemi duke ecur me hapin e kohës përsa i përket rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

Rezervimi në faqen tonë është i shpejtë dhe i thjeshtë. Nëse keni kërkesa specifike, ekipi ynë I Operacioneve do të jetë gati për t'ju asistuar.

KONFIRMIMI I REZERVIMIT ME E-MAIL

Menjëherë pasi të keni kryer rezervimin, një e-mail me të gjitha detajet e rezervimit do të vijë në adresën tuaj.

PAGESA PER REZERVIMIN

Pagesa per rezervimin do te kryhet ne dy pjese: 50% e pageses do te kryhet ne momentin e rezervimit, 50% deri ne 21 dite para nisjes

Nëse dëshironi të ndryshoni specifikat e rezervimit tuaj, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose me e-mail.

POLITIKAT E KANCELIMEVE

Ne rast te anulimit nga klienti aplikohen penalitetet si me poshte :

40 % nese anulimi behet deri 30 dite perpara nisjes

75 % nese anulimi behet 30 deri ne 15 dite perpara nisjes 100% nese anulimi behet 14 dite perpara nisjes

Nese klienti qe kerkon te anulloje udhëtimin e zëvendeson rezervimin e tij me nje person tjetër, atehere politikat e anulimeve do te diksutohen sipas rastit konkret.

Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet personalisht (ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit kur udhëtimi është rezervuar në grup) në njërin nga zyrat e agjencisë ose duke dërguar e-mail në adresën info@etg.al për t'u tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë.